



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
RKTORATI

**NJOFTIM**

**PËR APLIKIMET DHE REGJISTRIMET NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE  
“MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE”, ME KOHË TË PLOTË,  
NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT**

Mbështetur në Vendimin e Rektoratit Nr. 168, dt. 19.09.2018 “Mbi aplikimet dhe regjistrimet në ciklin e dytë të studimeve në “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, me kohë të plotë, në UST” , pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit fillojnë aplikimet për programet e studimit të ciklit të dytë të studimeve:

- **Master Profesional – “Aktivitet Fizik dhe Rekreacion-Trainer fitness”**
- **Master professional – “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”**
- **Master i Shkencave – “Aktivitet Fizik dhe Shëndeti”**

Aplikimet e kandidatëve kryhen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve në datat **24 Shtator 2017 deri 12 tetor 2017**, nga ora 8<sup>00</sup> deri 15<sup>00</sup>.

*Pwr Master professional – “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” kanë të drejtë të Aplikojnë kandidatë që kanë përfunduar studimet:*

- *Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes të UST-së.*
- *Bachelor në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit të UST-së.*
- *Bachelor në Shkenca Sportive në institucione të tjera të arsimit të lartë brënda dhe jashtë vendit.*
- *Kandidatë nga institucione të menaxhimit të sportit dhe turizmit sportiv (shoqata, federata, klube sportive) që kanë përfunduar studime në shkencat sportive.*
- *Gjithashtu kanë të drejtë të aplikojnë kandidatë që kanë kryer studime bachelor, në programe studimi të shkencave ekonomike, në institucione të tjera të Arsimit të Lartë. Këta kandidatë do të shlyejnë 5 kredite nga shkencat sportive.*

*Kriteret që do të plotësojnë kandidatët janë kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Nr. 6, dt. 19.01.2017, për ciklin e dytë të studimeve Master Professional.*

Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon në sekretarinë mësimore, dokumentacionin siç është përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 26, dt. 30.07.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 18, datë 21.05.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit

të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2018 -2019", Kreu IV/9.

*Kandidati dorëzon në sekretarinë mësimore, dokumentacionin e mëposhtëm:*

a. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.

b. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (original ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.

c. Formulari i aplikimit (Plotesohet në sekretarinë mësimore);

d. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

e. Dy fotografi personale.

f. Fleta “Faturë Arketimi”, me të cilën kandidati do të paraqitet në banke për të bërë pagesën e tarifës, mund të shkarkohet nga faqja Web e UST nga vetë kandidati.

Tarifa për aplikimin dhe regjistrimin të fituesve për program të dytë studimit për të dy fakultetet janë:

Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve)	2500lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve )	3000lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (trasferim studimesh në programe të ciklit e dytë të studimeve)	3000lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2000lekë

Informacion i plotë për aplikimet dhe regjistrimet, për udhëzimin e MASR nr. 26, dt. 30. 07. 2018 dhe në udhëzimin nr. 18, datë 21.05.2018, vendimin e Rektorit për aplikimet gjëndet në faqen Web të UST dhe pranë sekretarive mesimore.

**REKTORATI**